

**❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE**

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

**❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES**

Oficer QAQC

**❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT**

Oficeri i Sigurimit dhe Kontrollit të Cilësive ka përgjegjësi për implementimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Cilësive së projektit si edhe sigurohet që instalimet në kantier të jenë në përputhje me Politikën e Cilësive së kompanisë bashkë me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe kërkesat e klientit.

**❖ DETYRAT KRYESORE**

- Zbaton Planin e Cilësive dhe Planin e Kontrollit dhe Inspektimit në Kantier;
- Paraqet këshilla për inspektim grupit të Zbatimit të Projektit mbi çështje të cilësive;
- Vendos dhe mirëmban mardhenie të mira me Klientin dhe oficeret e tyre;
- Kujdeset që aktivitetet ndërtimore të nenkontraktoreve të kryehen në cilësi dhe duhur në kohën e duhur;
- Sigurohet që të gjitha dokumentat në lidhje me projektin janë të azhurnuara dhe të disponueshme për inspektim;
- Identifikon problematikat në kantier për sa i përket cilësive në materiale dhe puntori;
- Pret, inspekton materialet e ardhura në kantier dhe sigurohet që ato të jenë sipas specifikimeve teknike dhe atyre të perzgjedhur nga kompania;
- Zhvillon aktivitetet sipas planeve të inspektimit (pritje, në proces dhe në fazë finale);
- Raporton në bazë ditore për aktivitetet e cilësive në kantier;
- Asiston dhe drejton investigim në terren në prani dhe të Kordinatorit të cilësive;
- Kordinon, kontrollon dhe shpërndan të gjithë dokumentacionin të cilësive;
- Monitoron të gjitha aktivitetet e cilësive në projekt;
- Asiston në të gjitha auditet e brendshme dhe të jashtme të kompanisë;
- Asiston në mbledhjet e cilësive që organizojnë klientet (në kantier);
- Merret me korrespondencën hyrje/dalje të cilësive përfshirë dhe shpërndarjen e Kërkesave për Inspektim;
- Raporton problematikat me kthimet dhe mospranimet dhe ndjek NCR të hapura mbi materialet;
- Raporton statistika;
- Asiston në përgatitjen e të gjithë dokumentacionit përmbysës së projektit;
- Ndjek Raportet e Jo Konformitetit;
- Monitoron dhe bashkëvepron me eprorin;
- Zbaton dhe mirëmban, monitoron dhe ndjek, rregjistrat duke përfshirë këtu Inspektimin e Materialeve, Jo-Konformiteteve/Masave Korrigjuese, etj.
- Përgatit raportin e progresit javor/mujor/vjetor.

- Kordinon dhe ndjek testimet ne kantier

#### ❖ KRITERET KRYESORE

- Master Niveli i Pare ne Inxhinieri/ Universiteti Politeknik i Tiranes/ Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit;
- Njohuri te mira te gjuhes angleze;
- Mbi 3 vite experience pune ne pozicion te ngjashem ne fushen e ndertimit;
- Njohuri te programeve kompjuterike, Microsoft Office/AutoCad, Microsoft Office Project;
- Te jete i gatshem te punoje jashte Tirane.

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit [careers@gener2.al](mailto:careers@gener2.al) ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare [www.gener2.al](http://www.gener2.al) ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 25 Maj 2022, ora 17:00**.

\* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale